



## SYLLABUS I LËNDËS “BAZAT E STATISTIKËS”

<b>Të dhëna bazike të lëndës</b>	
<b>Njësia akademike:</b>	<b>Fakulteti i Shkencave të Jeta dhe Mjedisit</b>
<b>Titulli i lëndës:</b>	<b>Bazat e statistikes</b>
<b>Programi:</b>	<b>Shkencat e Pyjeve dhe Mjedisit</b>
<b>Niveli:</b>	<b>Bachelor</b>
<b>Statusi lëndës:</b>	<b>Zgjedhore</b>
<b>Viti i studimeve:</b>	<b>Viti i dyte</b>
<b>Numri i orëve në javë:</b>	<b>2+1</b>
<b>Vlera në kredi – ECTS:</b>	<b>3</b>
<b>Koha / lokacioni:</b>	<b>Do shpallet</b>
<b>Mësimdhënësi i lëndës:</b>	<b>Prof.Asoc.Dr. Mirvjena Kellezi</b>
<b>Të dhënat kontaktuese:</b>	<b>mirvjena.kortoci@uni-prizren.com</b>
<b>Përshkrimi i lëndës:</b>	<p>Nëpërmjet kësaj lënde studenët do të njihen me objektivat dhe rëndësinë e Statistikës dhe konkretisht: mbledhjen, analizën, interpretimin, paraqitjen dhe organizimin e të dhënave.</p> <p>Treguesit e pozicionit, variacionit dhe formes të shpërndarjeve eksperimentale. Kur një regjistrim i përgjithshëm (census) nuk është i realizueshëm, studiohet një nënkategori e zgjedhur e popullsisë që quhet një “mostër” ose në terminologjinë pyjore “provë”. Tërheqja e provës ka qënë subjekt i rastësisë, prandaj të dhënat numerike të rezultuara nga prova ose mostra janë pjesë e pasigurisë. Në mënyrë që ende të nxirren konkluzione kuptimplotë për të gjithë popullatën, statistika inferenciale është e nevojshme. Ajo përdor modele në të dhënat e mostrës për të nxjerrë konkluzione rreth popullatës që prova përfaqëson, duke marrë parasysh rastësinë (testimi i hipotezave statistikore). Qasja standarde është të testohet një hipotezë zero kundër një hipoteze alternative. Një rajon kritik është grup vlerash që çon në hedhjen poshtë të hipotezës zero. Mundësia e gabimeve të Llojit I është probabiliteti që Vlerësuesi i takon rajonit kritik duke qënë se hipoteza zero është e vërtetë (rëndësia statistikore) dhe gabimi i tipit II është probabiliteti që Vlerësuesi nuk i takon rajonit kritik të dhënë, kështu hipoteza alternative është e vërtetë. Fuqia statistikore e një testi është probabiliteti që ai në mënyrë të saktë refuzon hipotezën zero kur hipoteza zero është e rreme. Shumica e studimeve marrin në konsideratë vetëm pjesë apo mostëra të një popullate, kështu që rezultatet nuk përfaqësojnë plotësisht tërë popullatën. Çdo vlerësim i fituar nga prova (mostra) vetëm i përafrohet vlerës së popullatës. Intervalet e besimit lejojnë statisticienët të shprehin se sa afër vlerësimit të provës (mostrës) gjendet vlera e vërtetë e të gjithë popullatës. Shpesh ata janë të shprehur si intervale të besimit 95%.</p>

<b>Qëllimi i lëndës:</b>	Përveç rezultateve të veçanta të mësimit, ky kurs natyrisht synon që të formojë sjelljen e studentëve në lidhje me fushën e Statistikes. Në mënyrë të veçantë, sigurisht ka për qëllim të: motivojë studentëve një interes të brendshëm në të menduarit statistikor. Te krijoje besimin që Statistika është e rëndësishme për kërkime shkencore. Të sigurojë një themel dhe motivimin për ekspozimin ndaj ideve statistikore pas kursit.		
<b>Rezultatet e të nxënit:</b>	Ky modul ka për qëllim ti jape studentëve njohuri të mjaftueshme mbi: <ul style="list-style-type: none"> <li>Nocionet bazë të statistikës matematike të zbatuara në fushën e pyjeve si treguesit e shpërndarjeve eksperimentale.</li> <li>Shpërndarjet teorike që hasen në fushën e pyjeve.</li> </ul> Metodat e shqyrtimit të esencialitetit.		
<b>Ngarkesa e studentit (duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)</b>			
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	15	15
Punë praktike			
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Ushtrime në terren	-	-	-
Kollokfiume, seminare	-	-	-
Detyra të shtëpisë	-	-	-
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	1	5	5
Përgatitja përfundimtare për provim	1	5	5
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuis,provim final)	1	5	5
Projektet, prezantimet ,etj	-	-	-
<b>Totali</b>			<b>75 orë (3 ECTS)</b>
<b>Metodologjia e mësimdhënies:</b>	Ligjërata, diskutime, ushtrime laboratorike, ekspedita konsultime, seminare, projekte të pavarura, detyra shtëpie, kolokviume, detyre kursi, provime.		
<b>Metodologjia e vlerësimit:</b>	Vlerësimi i parë (kolokvium): 15%, Seminaret ose angazhime tjera: 10%,		



	Vijimi i rregullt: 5%, Provimi final: 70%, Total: 100%.
<b>Literatura</b>	
<b>Literatura primare:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• A.Salillari.P.Rrapo.S.Hoxha.H.Demiri 1998.Eksperimentimi Bujqesor.</li> <li>• David Freedman, Robert Pisani, Roger Purves 2007. Statistics (Fourth Edition).</li> <li>• G.Barbensi 1965.Elementi di biometria applicati alle scienze forestali.</li> <li>• Jim Fowler.Lou Cohen.Phil Jarvis 2005.Practical statistics for field biology (Second Edition)</li> <li>• Postoli. A. Tabaku. B. 1982. Metoda te statistikes dhe eksperimentimit shkencor ne pyje (I).</li> <li>• Postoli. A. Tabaku. B. 1982. Metoda te statistikes dhe eksperimentimit shkencor ne pyje (II).</li> </ul>
<b>Literatura shitesë:</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prem S. Mann with the help of Christopher Jay Lacke 2010 Introductory Statistics (Seventh Edition).</li> <li>• Robert R.SOKAL and F. James ROHLF 2006. Biometry (The principles and practice of statistics in biological research-Third Edition).</li> </ul>

<b>Plani i dizajnuar i mësimit:</b>		
<b>Java</b>	<b>Ligjërata</b>	<b>Ushtrime</b>
<i>Java e parë:</i>	Vrojtimet statistike, popullata statistike, regjistrimi dhe përpunimi fillestar i vrojtmeve, , dënduritë e shpërndarjeve empirike, paraqitjet grafike të shpërndarjeve njëpërmasore.	Ushtrime dhe shembuj konkrete mbi përpunimin fillestar te vrojtmeve, , dënduritë e shpërndarjeve empirike, paraqitjet grafike të shpërndarjeve njëpërmasore.
<i>Java e dytë:</i>	Vlerat mezatare : Mezatarja arithmetike e thjeshtë dhe e ponderuar; Mediana.	Llogaritja e mezatares arithmetike e thjeshtë dhe e ponderuar.Llogaritja e medianes (shembuj).
<i>Java e tretë:</i>	Treguesit e dispersionit : Varjanca dhe shmangia tip, varjanca e ponderuar dhe koeficjenti i varjacionit.	Shembuj mbi llogaritjen e varjances dhe shmangies tip, varjanca e

		ponderuar dhe koeficjenti i varjacionit.
<i>Java e katërt:</i>	Treguasit e formës së shpërndarjeve : Asimetria dhe teprica.	Ushtrime mbi llogaritjen e asimetria dhe teprices.
<i>Java e pestë:</i>	Shpërndarja binomiale; Përputhja e shpërndarjeve eksperimentale me shpërndarjen binomiale.	Metodologjia e përputhjes së shpërndarjeve eksperimentale me ato teorike-shpërndarja binomiale.
<i>Java e gjashtë:</i>	Shpërndarja Poisson dhe përputhja e shpërndarjeve eksperimentale me këtë shpërndarje teorike; Shpërndarja normale dhe përputhja e shpërndarjeve eksperimentale me të .	Metodologjia e përputhjes së shpërndarjeve eksperimentale me ato teorike-shpërndarja Poisson.
<i>Java e shtatë:</i>	Shpërndarja normal-logaritmike dhe normale e përgjithësuar dhe përputhjet e shpërndarjeve eksperimentale me to.	Metodologjia e përputhjes së shpërndarjeve eksperimentale me ato teorike-shpërndarja normale.
<i>Java e tetë:</i>	Shpërndarja student: Shpërndarja $X^2$ ; Shpërndarja e Fisherit të cilat përdoren për verifikimin e hipotezave statistike.	Kolokium mbi shpërndarjet eksperimentale dhe shpërndarjet teorike, përputhja e tyre.
<i>Java e nëntë:</i>	Përgjithësime; Hipoteza bazë, klasa të vërtetësisë, intervali i sigurisë ; Intervali i sigurisë së mezatares arithmetike kur njihet dhe kur nuk njihet shmangia tip teorike.	Detyre kursi mbi formimin dhe paraqitjen grafike të shpërndarjeve empirike, llogaritjen e treguesve të shpërndarjeve eksperimentale dhe metodologjinë e përputhjes së shpërndarjeve eksperimentale me ato teorike.
<i>Java e dhjetë:</i>	Esencialiteti i differences midis një mezatareje eksperimentale dhe një vlere të dhënë kur njihet dhe kur	Llogaritja e intervalit të sigurisë së mezatares arithmetike kur njihet dhe kur nuk njihet shmangia tip teorike.



	nuk njihet shmangia tip teorike.	
<i>Java e njëmbëdhjetë:</i>	Krahasimi i një varjance eksperimentale me një varjancë teorike të dhënë.	Ushtrime mbi esencjalitetin e differences midis një mezatareje eksperimentale dhe një vlere të dhënë kur njihet dhe kur nuk njihet shmangia tip teorike.
<i>Java e dymbëdhjetë:</i>	Verifikimi i vërtetësisë së differences midis dy varjancave.	Ushtrime mbi krahasimin e një varjance eksperimentale me një varjancë teorike të dhënë.
<i>Java e trembëdhjetë:</i>	Shqyrtimi i barazisë së shumë varjancave.	Ushtrime mbi verifikimin e vërtetësisë së differences midis dy varjancave. Shqyrtimi i barazisë së shumë varjancave.
<i>Java e katërbëdhjetë:</i>	Krahasimi i dy mezatareve eksperimentale kur varjancat teorike të popullatave përkatëse janë të barabarta ose jo.	Ushtrime mbi krahasimin e dy mezatareve eksperimentale kur varjancat teorike të popullatave përkatëse janë të barabarta ose jo. Krahasimi i efektit të dy mënyrave (trajtimeve) me metodën e çifteve.
<i>Java e pesëmbëdhjetë:</i>	Krahasimi i efektit të dy mënyrave (trajtimeve) me metodën e çifteve.	Kolokium mbi shqyrtimin e esencjalitetit në të gjitha rastet dhe verifikimi i hipotezave statistike
<b>Politikat akademike dhe kodi i sjelljes</b>		
Studentët janë të obliguar në vijimin e rregullt në ligjërata, marrin pjesë në vizita studimore në terren (ekskursion). Shkyçja e telefonave celularë, hyrja me kohë në sallën e mësimit dhe mbajtja e qetësisë në mësime po ashtu janë obligative.		